



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:257495

Datë: 24.06.2020

Numri i dokumentit: 00983714

P.nr. 996/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, ne çështjen penale ndaj të akuzuarve M.Z me mbrojtësin e tij Sevdail Robelli nga Gjilani, dhe B.Sh nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1765 /2019 të datës 05.11.2019, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 23.06.2020, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **M.Z** nga i ati F... dhe e ëma L..., e lindur R..., i lindur më dt....., në Gjilan, ku edhe jeton në rruga “...” p.n., me nr. personal të letërnjoftimit, ka të kryer shkollën e mesme, punon tek kompania “T...” në Gjilan, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar, dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, më datë 02.10.2019, rreth orës 13:45 min, në rrugën “Marie Shllaku”, në Gjilan, saktësisht tek pompa e derivateve “Shell” i pandehuri M.Z, me dashje, ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit B.Sh i cili ishte duke e mbushur me derivate Motoçikletën e tij në atë mënyrë që e godet me grushte në trup, dhe rrahja vazhdon edhe në pjesën tjetër ku i pandehuri e rrëzon në tokë të njejtin dhe e godet disa herë në pjesë të ndryshme të trupit, dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta me dashje dhe pa pëlqimin e tij e ka sulmuar, ka përdorur forcë fizike ndaj të sipërshënuarit.

-më çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke ju referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit M.Z, në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, dhe neneve 233 dhe 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. Të akuzuarin **M.Z**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin denimi do ta paguaj në afat prej 15 ditë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

II. Nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro) ndërsa nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënimi me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

III. Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

IV. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20.00 € (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

V. VEQOHET PROCEDURA PENALE ndaj të pandehurit B.Sh me vendbanim në rrugën “...” nr. ..., K. Gjilan, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 2 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1765/2019 të datës 05.11.2019 dhe në kuptim të paragrafit 3 të këtij neni, kundër aktvendimit nuk është lejuar ankesa.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 05.11.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.Nr.1765/2019, kundër të akuzuarve M.Z nga Gjilani për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe B.Sh nga Gjilani për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në shqyrtimin fillestar gjykata e ka veqar procedurën penale ndaj të pandehurit B.Sh, i cili nuk ka qenë prezent me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës penale e ka vazhduar procedurën penale ndaj të pandehurit M.Z, gjyqtari pas sigurimit të mendimit të palëve, me aktvendim procedural ka veqar procedurën penale kundër të akuzuarit në kuptim të nenit 36 të KPP.

Me datën 03.06.2020, në këtë gjykatë është pranuar marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan /Departamenti i përgjithshëm në një të anë dhe në anën tjetër të pandehurit M.Z me mbrojtësin e tij av. Sevdail Robelli. Sipas kësaj marrëveshje, Gjykatës i është rekomanduar, që ndaj të akuzuarit M.Z për shkak të veprës penale, të i shqiptohet dënimi me gjobë prej 300 € (treqind euro).

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 23.06.2020, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar

të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit M.Z, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Sevdail Robelli, se i akuzuari nuk ka qenë në as një mënyrë i detyruar apo i shtrënguar në as një mënyrë të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston as një nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-s.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pandehuri M.Z, ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-s. në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të pandehurin M.Z për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-s. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vetë.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të pandehurit M.Z të i shqiptohet dënim me gjobë, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan / Departamenti i Përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryejnë vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar dhe fakti që nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të pandehurit me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese janë rrezikshmëria shoqërore dhe përgjegjësia penale e të pandehurit.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me gjobë, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave

penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për të paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 996/2020 Më 23.06.2020

Sekretarja juridike,
Fatmire Sermaxhaj d.v

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Ky aktgjykim është i formës së prerë, ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3. të KPPRK-s.